

December 2, 1961

Telegram from Behar Shtylla to Ung Van Khiem

Citation:

"Telegram from Behar Shtylla to Ung Van Khiem", December 2, 1961, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1961 D.217
<https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/111807>

Summary:

This document is a telegram from Albanian Foreign Affairs Minister Behar Shtylla to the Foreign Affairs Minister of North Vietnam, Ung Van Khiem. Shtylla shares the same indignation as the Vietnamese minister towards the dangerous situation arising in Vietnam. According to Shtylla, Kennedy is trying to transform South Vietnam into a base of operations for aggression directed against the Democratic Republic of Vietnam. Taking into account other actions towards Laos and Cambodia, he believes Kennedy is attempting to convert Indochina into an American base. Shtylla states that the American policy in Vietnam violates the general international conventions of conduct, as well as the Vietnamese people's sovereignty. Shtylla expresses full solidarity with the Democratic Republic of Vietnam and supports its request that the chairmen of the Geneva Conference take measures against the American interference in South Vietnam.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

MPJ ARKIV

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja# Fleta:

Tirane, me 2 dhjetor 1961

I dashur shoku Minister,

Kam nderin t'ju njoftoj se mora letren tuaj te dates 30 tetor me ane te se ciles, n'emer te Qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit, terhiqni vemendjen e Qeverise se Republikes Popullore te Shqiperise mbi gjendjen serioze te krijuar ne Vietnamin Jugor si rjedhim i shtimit te nderhyrjes se imperializmit amerikan.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise ka ndjekur dhe ndjek kurdohere me vemendje te madhe gjendjen e rende te krijuar ne Vietnamin jugor nga regjimi satrap i klikes se Ngo Din Diemit dhe nga nderhyrja brutale ushtarake, politike dhe ekonomike e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes, ne kunderantim flagrant me marreveshjet e Gjeneves te vitit 1954 dhe me interesat jetike te popullit te Vietnamit. Qeveria shqiptare, e cila ka çmuar dhe mbeshtetur pa rezerva politiken paqesore konsekuente dhe perpjekjet e vendosura te qeveris se Republikes Demokratike te Vietnamit per zbatimin e marreveshjeve te Gjeneves dhe bashkimin paqesor t'Atdheut tuaj, e kupton plotesisht çqetesimin e justifikuar te qeverise tuaj lidhur me gjendjen e rende te krijuar, sidomos ne periudhen e fundit, ne pjesen jugore te Vietnamit, dhe ajo

Shokut Ung Van Khien

Minister i Puneve te Jashtme

te Republikes Demokratike te Vietnamit

H a n o i

MPJ ARKIV

Viti
Dosja

DEKLASIFIKUAR

- 2 -

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:

vete nuk munt te mos qetesohet per kete gjendje serioze qe ka te beje me popullin vella te Vietnamit dhe qe perben nje kercenim serioz per paqen ne Indokina dhe ne Azine jugelindore.

Faktet e paraqitura ne letren tuaj te lartpermendur meritojne te studjohen me kujdesin me te math nga te gjitha qeverite qe jane te interesuara per zbatimin e marreveshjeve te Gjeneves dhe per ruajtjen e paqes ne bote. Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise pajtohet plotesisht me vleresimin qe i ben ketij problemi qeveria e Republikes Demokratike te Vietnamit. Veprimtaria agresive e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes ne Vietnamin e jugut, ashtu si edhe ne pjese te tjera te botes, eshte shtuar posaqerisht qe nga ardhja ne fuqi e Presidentit Kanedi. Imperializmi amerikan ka hyre hapet ne rrugen e provokimeve dhe te pregatitjes per agresion kunder vendeve te kampit socialist ne radhe te pare si dhe kunder vendeve te tjera paqedashes. Ai po perpiqet ta ktheje Vietnamin jugor ne nje baze agresioni kunder Republikes Demokratike te Vietnamit, ne agresionin e tij ne Laos dhe me veprimet e tij agresive ne drejtim te Kamboxhes ay synon te njejtin qellim, kthimin e gjitha Indokines ne nje placdarm amerikan, ne nje baze aventurash ushtarake ne Azine jugelindore. Kohet e fundit, qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes po thekson nderhyrjen e saj nen te gjitha format ne Vietnamin jugor. Nuk munt te lihet pa permendur fakti se, pas visitave te nenpresidentit L. Ikonson dhe te gjeneralit Fejlor, ne Vietnamin jugor jane derguar kontingjente te reja te forcave ushtarake amerikane, mjete te reja luftimi si dhe ndihma te ndryshme per te shtuar ne nje mase te konsiderueshme trupat e Ngo Din Diemit.

Imperialistet amerikane, par te justifikuar nderhyrjen e tyre agresive ne Vietnamin jugor kane shperthyer fushata qpfjesh kunder Republikes Demokratike te Vietnamit. Por dihet mire

MPJ ARKIV

I DEKLASIFIKUAR

- 3 -

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja №
Fleta:

se i vetmi rrezik qe e kercenon Vietnamin jugor eshte pikerisht nderhyrja brutale e Shteteve te Bashkuara t'Amrikes dhe sundimi kriminal i kukllës se tyre Ego Din Dien, qe e kanë kthyer pjesen jugore t'Atdheut tuaj ne nje vent torturash, krimesh dhe njerimi revoltues. Prova me elokvente e kesaj gjendjeje te tmerrshme eshte lufta heroike qe po ben vete populli i Vietnamit jugor kunder nderhyrjes imperialiste amerikane dhe sundimit te Ego Din Dienit dhe qe ka fituar simpatine e te gjithë popujve liridashes. Nga ana tjetër, Republika Demokratike e Vietnamit ka luftuar dhe lufton me kembengulje per shbatimin e marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954, per bashkimin te Vietnamit ne rruge paqesore, ne perputhje me aspiratat e zjarra te mbare popullit vietnamez. Realizimet e Republikës Demokratike te Vietnamit ne ndertimin paqesor te vendit, perpjekjet dhe propozimet e saj te pareshtura per te realizuar bashkimin paqesor te vendit dhe e gjithë politika e saj e jashteme paqesore frymazojne popullin e Vietnamit jugor, kanë ritur autoritetin nderkombetar te Republikës Demokratike te Vietnamit dhe kanë fercuar qeshtjen e paqes.

Duke denuar ne vendosmeri nderhyrjen dhe aktet e vazhduara agresive te Shteteve te Bashkuara t'Amrikes ne Vietnamin jugor si nje komplot kriminal kunder popullit vietnamez dhe bashkimin paqesor te Vietnamit dhe si nje kercenim serioz kunder paqes ne Indokine dhe ne Azine jugelindore, qeveria e Republikës Popullore te Shqiperise shpreh solidaritetin e saj te plots me qeverine e Republikës Demokratike te Vietnamit dhe mbeshtet plotesisht kerkesen e saj qe Kryetaret e Konferences se Gjeneves te vitit 1954 te marrin te gjitha masat e duhura per ti dhene fund nderhyrjes se rrezikeshme t'imperializmit amerikan ne Vietnamin jugor dhe per te realizuar disponitat e marreveshjes se Gjeneves te vitit 1954, gje qe do te kontribuonte ne shkalle te ndieshme ne uljen e tensionit nderkombetar dhe forcimin e paqes ne Indokine dhe ne Azine jugelindore. Populli vella vietnamez dhe qeveria e Republikës Demokra-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:

tike e Vietnamit le te jene te sigurte se qeveria e Republikes Popullore e Shqiperise do te beje qmos per te kontribuar ne përpjekjet per ndalimin e ndërhyrjes se imperializmit amerikan ne Vietnamin Jugor dhe per respektimin e marrveshjeve te Gjeneves, per uljen e tensionit dhe sigurimin e pages ne Indokine dhe ne bote.

Duke shprehur bindjen e thelle se qeshtja e drejte e popullit vella vietnamez do te fitoje dhe imperializmi amerikan do te mbulohet me disfate dhe turp ne pjesen jugore t'Atdheut tuaj, ju lutem pranoni, shoku Minister, sigurimin e konsiderates time shume te larte.-

Ministri i Punëve të Jashtme
i Republikës Popullore të Shqipërisë

Behar Shylla